

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS**  
Prishtinë, Kosovë

**PASQYRAT FINANCIARE**  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022

dhe  
**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUAR**

Contents

RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR.....	6
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE .....	8
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	9
3. Paraja dhe ekuivalentëve e saj .....	13
4. Fonde të mbledhura për ITF-në.....	13
5. Të hyrat e shtyra .....	13
6. Të hyrat nga grantet .....	14
7. Të hyrat e tjera.....	14
8. Pagat dhe mëditjet.....	14
9. Premite dhe shpërblimet .....	15
10. Anëtarësia vjetore .....	15
11. Shpenzimet sipas projekteve.....	16
12. Të hyrat e shtyera sipas donatorit dhe projektit .....	17
14. Të hyrat e shtyera sipas donatorit dhe projektit (vazhdim) .....	18
13. Kontigjencat dhe zotimet .....	18
14. Ngjarjet pasuese .....	18

## RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

Për: Bordin e Federatës së Tenisit të Kosovës

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Federatës së Tenisit të Kosovës" (Federata), të cilat përbëhen nga Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2022, Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, dhe Pasqyrën e flukseve monetare për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të "Federatës së Tenisit të Kosovës" më 31 dhjetor 2022 dhe performancën e tij financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin e përfunduar më datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

**Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**  
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpallur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

### Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomali mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.



Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përfutur e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfutura deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Zeka  
Auditor Ligjor

Baker Tilly Kosovo  
30 mars 2023



Baker Tilly Kosovo L.L.C  
Prishtinë

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)**  
**PASQYRA E POZITËS FINANCIARE**  
 Me 31 dhjetor 2022  
 (të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

		Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
	Shënimi		
<b>Pasuritë</b>			
<b>Pasuria qarkulluese</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	3	132	27,809
Të arkëtueshmet		5,420	-
<b>Gjithsej pasuria qarkulluese</b>		<b>5,552</b>	<b>27,809</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>			
		<b>5,552</b>	<b>27,809</b>
<b>Detyrimet</b>			
Fonde të mbledhura për ITF-në	4	1,290	1,265
Të hyrat e shtyra	5	(1,158)	26,498
Llogaritë e pagueshme		-	47
Huatë	6	5,420	-
<b>Gjithsej detyrimet qarkulluese</b>		<b>5,552</b>	<b>27,809</b>
<b>GJITHSEJ BALANCI I FONDEVE DHE DETYRIMET</b>			
		<b>5,552</b>	<b>27,809</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar me 21 mars 2023 në emër të Menaxhmentit të organizatës:

Kryetar  
**Jeton Hadërgjonaj**




Sekretare e Përgjithshme  
**Fjolla Ibishi**



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)**  
**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**  
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022  
*(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)*

Për vitin e përfunduar	Shënimi	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga grantet dhe donacionet	7	115,201	174,330
Të hyrat e tjera	8	1,927	4,287
<b>Gjithsej të hyrat</b>		<b>117,128</b>	<b>178,618</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe mëditjet	9	(37,492)	(37,608)
Transport		(21,716)	(19,266)
Pajisje, topa tenisi dhe ndihma për pandemi		(18,021)	(43,502)
Premitë dhe shpërblimet	10	(4,536)	(20,535)
Fjetja dhe akomodimi		(9,987)	(16,241)
Anëtarësitë vjetore		(300)	(8,848)
Ushqim e pije		(3,304)	(7,515)
Hyrjet në turne		(688)	(4,317)
Mbledhjet dhe konferencat		(9,410)	(5,360)
Shpenzimet e zyrës dhe bankare		(5,176)	(5,827)
Fushat me qira		(305)	(3,080)
Marketing		(6,193)	(6,520)
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>(117,128)</b>	<b>(178,619)</b>
<b>Suficiti / (Deficiti) neto për vitin</b>		-	-

*Shënimet shoqëruese nga 8 deri në 18 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË BALANCIN E FONDEVE**  
Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

<b>Balanci i fondeve</b>	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>Me 31 dhjetor 2021</b>
Balanci i fondeve në fillim të vitit	26,498	14,811
Shtuar: Për fondet e pranuar gjatë vitit nga doantoret	87,545	186,018
Shtuar: Për të hyrat nga anëtarët	1,927	4,287
Zvogëluar: Për fondet e shpenzuara gjatë vitit	(117,128)	(178,619)
<b>Balanci i fondeve me 31 janar</b>	<b>(1,158)</b>	<b>26,498</b>



# FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK) SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

## Hyrje

Federata e Tenisit e Kosovës ("Federata" ose "FTK") është e regjistruar si organizatë jo-qeveritare në bazë të ligjit Nr. 06 / L-043, me numër 5100627-5 pranë Ministrisë së Administratës Publike të Republikës së Kosovës. Selia e organizatës është në adresën: Shtëpia e Sportit, Rr. "Agim Ramadani" Nr. 253, 10000 Prishtinë.

Federata është organizatë jo-fitimprurëse që ka për objekt kryesor zhvillimin dhe organizimin e garave zyrtare të sportit të tenisit në territorin e Republikës së Kosovës.

Federata është themeluar në vitin 1996, ndërkohë që nga viti 1998 është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës ("KOK"). Nga viti 2016 Federata është anëtare e plotë edhe e Federatës Evropiane të Tenisit ("FET") dhe Federatës Ndërkombëtare të Tenisit ("FNT").

Organet qeverisëse të Federatës janë: Kuvendi, Komisioni Mbikëqyrës, Bordi Ekzekutiv, dhe Sekretari i Përgjithshëm. Kuvendi është organi më i lartë i Federatës dhe takohet një herë në vit. Bordi Ekzekutiv mban mbledhje së paku një herë në tre muaj. Bordi Ekzekutiv vendos mbi politikat dhe aktivitetet e Federatës.

## Anëtarët e Federatës

Anëtarë të Federatës janë klubet private a publike të tenisit të Republikës së Kosovës të cilat duan të anëtarësohen në Federatë, dhe të cilat pranohen si klube anëtare nga Kuvendi i Federatës me shumicë votash. Delegatët e Anëtarëve të Federatës përbëjnë Kuvendin e Federatës.

Në datën e këtij raporti anëtarë të Federatës janë:

1. KT Match Point  
K.T. Prishtina;
2. K.T. DielliX, Prishtinë;
3. K.T. Prizreni;
4. K.T. Peja;
5. K.T. Trepça, Mitrovicë;
6. K.T. Rilindja, Prishtinë;
7. K.T. Sporek, Gjakovë;
8. K.T. Drenica, Skenderaj;
9. K.T. Gjakova;
11. K.T. Kalaja, Prizren;
12. K.T. HotShot, Gjakovë;
13. T. K. Tennis Arena, Llapnasellë;
19. K.T. Bifurkacioni – Ferizaj.
20. K.T. Istog.
21. K.T. Vushtrija;

## Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv përbëhet prej 5 anëtarëve. Në datat e raportimit, 31 dhjetor 2022 anëtarët e Bordit Ekzekutiv ishin:

- Jeton Hadërgjonaj – President;
- Blerina Mati – Nënkryetare;
- Ylber Shamolli -Nënkryetar;
- Driton Latifi- Anëtar Bordi;
- Lorik Haxhishabani- Anëtar Bordi;



# FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK) SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

## 0. Hyrje (vazhdim)

Me 31 dhjetor 2021 anëtarët e Bordit Ekzekutiv ishin:

- Jeton Hadërgjonaj – President;
- Blerina Mati – Nënkyetare;
- Ylber Shamolli -Nënkyetar;
- Driton Latifi- Anëtar Bordi;
- Lorik Haxhishabani- Anëtar Bordi;

## Administrata

Me 31 dhjetor 2022 Federata ka Sekretaren e Përgjithshme dhe Komisionerin e Ndeshjeve të punësuar me orar të plotë (2021: Sekretarja me orar të plotë dhe Komisioneri me orar të plotë).

## Aktivitetet kryesore

Gjatë vitit 2022, Federata ka zhvilluar këto aktivitete / projekte kryesore:

ITF/TE U&12 Training Camp, Antal, Turqi  
ITF/TE Development Championships Week 1 21-27 Feb  
ITF/TE U&12 Training Camp, Antal, Turqi  
ITF/TE Development Championships Week 1 28 Feb-06 Mar  
TK Tennispark 35+ Shkup 12-15 Mar  
Albania Bowl U10, U12, U14, U18 Shkodër, 18-20 Mar  
TK Jug U18 Shkup 19-22 Mar  
TK Fan Tennis Green Shkup, 2-3 Apr  
TC Academy Aerodrom Shkup, 2-4 Apr  
TC Tumba 30+, 50+ Kumanovë 2-4 Apr  
TK Tumba Red, Orange Kumanovë 9-10 Apr  
TE Tirana Open U12 Tiranë, 04-10 Apr  
TC Jug U16 Shkup 9-11 Apr  
TK Aerodrom Green Shkup, 16-18 Apr  
TE Tirana Open U14 Tiranë, 11-17 Apr  
TC Jug U18 Shkup 16-18 Apr  
TE Bellevue Cup U12 Ulqin, 18-24 Apr  
TE National Sport Park U14 Tiranë, 18-24 Apr  
TK Negotinë Red Orange Negotinë, 30 Apr- 1 May  
TE Cungu Open U14 Ulqin, 25 Apr-1 May  
TK Borec U12 Veles, 7-9 May  
TE Tirana Open U16 Tiranë, 2-8 May  
Skopje Open J4 Shkup 2-8 May  
TC Crna Reka Kavadar 7-9 May  
TK Mondano ROG Shkup, 14-15 May  
TK Tennispark U14 Shkup, 14-16 May  
TE National Sport U16 Tiranë, 9-15 May  
Tennispark Pointer Open J5 Shkup 10-15 May  
Tirana Open J5 Tirana 16-21 May  
TE Jug Open U14 Shkup, 23-29 May  
Podgorica Open J4 Podgorica 23-28 May  
TE Bitola Open U14 Bitol, 30 May-5 Jun  
Montenegro Open J4 Ulqin 30 May-04 Jun  
TE Tennispark Pointer U16 Shkup, 6-12 Jun  
TE Crna Reka Open U16 Kavadarci, 13-19 Jun  
Trebjesa Open J5 Niksic 13-19 Jun  
Lojërat Mesdhetare 2022 25 Jun- 5 Jul  
TE Podgorica Rio Verde U16 Podgoricë, 4-10 Jul  
TE Podgorica Rio Verde U16 Podgoricë, 11-17 Jul  
TE Niksic Open U16 Niksic, 18-24 Jul  
TE Eminent Podgorica Open U16 Podgoricë, 25- 31 Jul  
TE Neotel Open U16 Shkup, 1-7 Aug

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)  
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

**1. Hyrje (vazhdim)**

**Aktivitet kryesore (vazhdim)**

TE Eminent Podgorica U12 Podgoricë, 15-21 Aug  
TE Peja Open U16 Peje, 29 Aug-04 Sep  
Kosova Open J5 Peja 5-11 Sep  
TE Shkodra Open U16 Shkoder, 12-18 Sep  
National Sport Park J5 Tirana 19-24 Sep  
Albania Open J5 Tirana 26 Sep-01 Oct

Gjatë vitit 2021, Federata ka zhvilluar këto aktivitete / projekte kryesore:

- a) Laureatat;
- b) Përfaqësimi në Komitetet e Tennis Europe për zhvillim;
- c) Shpese Olimpike 2022;
- d) Kampi për grupmoshën U12;
- e) Kampi për grupmoshën U14;
- f) Kampionati Botëror i tenisit për femra "Billie Jean King Cup 2022";
- g) Kampionati Botëror i tenisit për meshkuj "Davis Cup 2022";
- h) Peja OPEN 2022 – U16/TENNISEUROPE;
- i) J5 Kosova OPEN 2022 – U18;
- j) U12 Camp & Development Championships 2022;
- k) Ceremonia e Inaugurimit të Balonit;
- l) Kampionati Ekipor 2022 dhe Ladies Open 2022;
- m) Përkrahja e trajnerëve dhe klubeve të tenisit;
- n) Mbikëqyrja e turneve zyrtare në Kosovë;
- o) Furnizimi me pajisje sportive (topa të tenisit) për turnetë zyrtarë;
- p) Programet e "Tenisit Dimëror".

# FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK) SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

## PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT DHE INFORMATA TË PËRGJITHSHME (vazhdim)

### 2.1. Përmbledhje e politikave kontabël

Organizata mban regjistrat e saj të kontabilitetit në bazën e modifikuar të parave të gatshme të kontabilitetit. Prandaj, të ardhurat regjistrohen kur paratë merren dhe shpenzimet regjistrohen kur paguhen. Modifikimet në bazën e parave të gatshme të kontabilitetit kanë të bëjnë me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të cilat njihen në fund të periudhës raportuese.

### 2.2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë së kosts historike në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Kosovë.

### 2.3. Valuta funksionale dhe transaksionet në valuta të huaja

Federata e Tenisit së Kosovës i regjistron transaksionet në Euro. Të gjitha shumat e raportuara në Pasqyrën e pozitës financiare dhe në ndryshimet në asetet neto janë raportuar në Euro.

Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen sipas normave të këmbimit në fuqi me datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe detyrimet monetare në valuta të huaja janë konvertuar sipas normës së këmbimit në datën e Bilancit të Gjendjes. Fitimi apo humbja si rezultat i këmbimit është regjistruar në Pasqyrën e të Ardhurave.

### 2.4. Tatimi në të ardhura

Federata është një organizatë joqeveritare (OJQ). Sipas ligjit nr. 06 / L-105 për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave, OJQ-të, të ardhurat totale të të cilave përdoren për qëllimet e tyre të përfitimit publik, përjashtohen nga taksat.

### 2.5. Prona, paisja dhe impiantet

#### *Njohja dhe matja*

Pajisjet e Federatës paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e datës së blerjes minus zhvlerësimi i akumuluar pasues dhe humbjet pasuese të akumuluar nga rënia në vlerë e tyre.

Zhvlerësimi njihet në mënyrë që redukton koston apo vlerësimin e mjeteve për vlerat e mbetura mbi jetëgjatësinë e tyre, duke përdorur metodën lineare. Jetëgjatësia, vlera e mbetur dhe metoda zhvlerësimit rishikohen në çdo datë raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësimin e llogaritur në periudhat e ardhshme.

Jetëgjatësia e parashikuar e zërave të pajisjeve janë si më poshtë:

Kompjuterë dhe harduerë të tjerë:	3 vite
Orendi:	5 vite
Automjete:	5 vite

Pasuritë që i nënshktohen zhvlerësimit kanë kosto blerëse mbi 1,000 euro dhe jetëgjatësi mbi 12 muaj. Në datat e raportimit nuk kishte pajisje të tilla.

### 2.6. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në dorë dhe para të depozituara në bankë.

### 2.7. Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja rikthehen me kursin e këmbimit në fund të periudhës raportuese. Diferencat në valutë të huaj që vijnë nga ri-përktimi njihen në fitim ose humbje.



## FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK) SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

### PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT DHE INFORMATA TË PËRGJITHSHME (vazhdim)

#### 2.8. Të hyrat

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për grantet dhe/ose anëtarësitë në rrjedhën normale të organizatës.

##### *Grantet*

Grantet njihen në pasqyrën e pozicionit fillestar fillimisht si të hyra të shtyra kur ato janë pranuar dhe kur pritet që Federata do të veprojë në përputhje me kushtet e bashkangjitura me to.

Grantet të cilat kompensojnë Federatën për shpenzimet e ndodhura njihen si të hyra në pasqyrën e të ardhurave në baza sistematike në periudhën në të cilën shpenzimet kanë ndodhur.

Grantet të cilat kompensojnë Federatën për kostot e një aseti njihen në pasqyrën e të ardhurave në baza sistematike përgjatë jetëgjatësisë së asetit.

Grantet që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet ose humbjet tashmë të ndodhura, ose për qëllim të dhënies së mbështetjes së menjëhershme për Federatën pa shpenzime të ndërlidhura, njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

#### 2.8. Të hyrat (vazhdim)

##### *Të hyrat nga anëtarësitë*

Të hyrat për pagesat e anëtarësive vjetore të referëve, klubeve, trajnerëve, dhe tenistëve, njihen si të hyra në periudhën në të cilën ato arkëtohen.

#### 2.9. Shpenzimet

Organizata njih shpenzimet në momentin e ndodhjes. Shpenzimet regjistrohen sipas bazës akruale. Shpenzimet e organizatës përbëhen nga shpenzimet e personeli, shpenzimet operative dhe administative, programore dhe tjera të përgjithshme.

#### 2.10. Llogaritë e pagushme

Llogaritë e pagushme paraqesin detyrimet më datë ndaj furnitorëve apo furnizuesëve të organizatës dhe të tjera.

#### 2.11. Të hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra janë një e ardhur/donacion për të cilin paratë e gatshme janë mbledhur nga organizata, por ende nuk janë shpenzuar. Si pasojë kjo përgjegjësi ndodh kur 'ANF' merr parapagim për një projekt që do të zbatohet në të ardhmen.

#### 2.12. Deficiti i të ardhurave mbi shpenzimet

Bilanci negativ (deficiti) është rezultat i dhurimeve dhe kostove të implementuara të projektit deri në fund të vitit.

#### 2.13. Përfitimet e punonjësve

Organizata jep kontribute për përfitimet e punonjësve në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Kontributet shpenzohen kur ndodhin.

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)  
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

**3. Paraja dhe ekuivalentëve e saj**

	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>Me 31 dhjetor 2021</b>
NLB Bank (EUR)	66	24,275
NLB Bank (USD)	-	3,527
BpB Bank (EUR)	66	6
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>132</b>	<b>27,809</b>

Federata më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 nuk mban para në arkë dhe të gjitha pagesat i bën me transfer bankar.

**4. Të arkëtueshmet**

Të arkëtueshmet janë fonde që Federata pret ti pranojë gjatë vitit të ardhshëm nga donatorët. Federata me 31 dhjetor 2022 ka pasur të arkëtueshmet në vlerë 5,420 Euro.

**4. Fonde të mbledhura për ITF-në**

Për shkak të vështirësive teknologjike, tenistët e Kosovës nuk mund të paguanin në internet për anëtarësimin e tyre në ITF në vitin 2022 (IPIN). Është rënë dakord me ITF-në që Federata do të mbledhë pagesat e anëtarësimit në emër të ITF-së, dhe më pas t'i përcjellë ato në ITF. Bilanci i pagueshëm ITF-së në datën e raportimit paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar.

**5. Të hyrat e shtyra**

	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>Me 31 dhjetor 2021</b>
ITF - Granti për digjitalizim	612	612
ITF - Grante tjera	7,511	2,133
Tennis Europe - Granti I Presidentit	11	15
Tennis Europe - Grante tjera	-	2,271
MKRS - Grant I përgjithshëm	(13,509)	228
MKRS - Granti për ringjallje ekonomike	-	20,000
KOK - Granti "Ndihme e përgjithshme pandemike"	698	700
BPB	539	539
ETF / PRESIDENT FUND	15	-
Komuna e Prishtinës	619	-
ETF - National Program	2	-
ETF - Coaching workshop	133	-
ETF - Development Championship	2,210	-
<b>Gjithsej të hyrat e shtyra</b>	<b>(1,158)</b>	<b>26,498</b>

**6. Huatë**

Federata ka marr hua fonde për të mbuluar shpenzimet, gjatë vitit të ardhshëm pret të arketojë këto mjete nga donatorët dhe të paguaj fondet e huazuara.

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)  
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

**7. Të hyrat nga grantet**

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Grantet nga Ministria per Kulture Rini dhe Sport	38,565	96,250
Grantet nga ITF	38,469	38,984
Grantet nga ETF	2,397	10,784
Grantet nga Komuna e Prishtines	3,240	-
Grantet nga KOK	1,400	-
Grant nga National Program	2,500	-
Grant nga Development Workshop 2022	500	-
Gant participation - AGM (ITF) 2021	473	-
Sponsorizim nga BpB Bank	-	25,000
Sponsorizim nga Eurkos JH	-	15,000
<b>Gjithsej grantet dhe donacionet e reja</b>	<b>87,545</b>	<b>186,018</b>
<i>plus</i> Të hyrat e shtyera në fillim të vitit	26,499	14,811
<i>minus</i> Të hyrat e shtyera në fund të vitit)	(26,498)	1,158
<b>Gjithsej të hyrat nga grantet dhe donacionet</b>	<b>115,201</b>	<b>174,330</b>

**8. Të hyrat e tjera**

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
<b>Për vitin e përfunduar</b>		
Anëtarësitë e lojtarëve	690	1,850
Anëtarësitë e klubeve	500	-
Anëtarësitë e trajnerëve	202	-
Anëtarësitë e referëve	50	-
Pjesëmarrjet në kampe / kurse	-	1,671
Të hyrat e tjera	485	767
<b>Gjithsej grantet dhe donacionet e reja</b>	<b>1,927</b>	<b>4,287</b>

**9. Pagat dhe mëditjet**

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
<b>Për vitin e përfunduar</b>		
<b>Pagat</b>		
Sekretarët e Përgjithshëm	6,660	8,252
Komisari i Garave	4,400	5,698
UD Sekretari	2,113	-
<b>Gjithsej</b>	<b>13,173</b>	<b>13,949</b>
<b>Mëditjet</b>		
Referet mbikqyres	3,310	10,207
Trajneret e tenisit	9,280	5,805
Ndihmesat dhe koordinoret	1,350	735
Trajneret kondicionale dhe fiziote	-	2,604
Kryetari	3,550	3,830
Meditje per fotografet	700	479
Perfaqesuesja	491	-
Tatimet dhe kontributet	5,638	-
<b>Gjithsej</b>	<b>24,319</b>	<b>23,659</b>
<b>Gjithsej pagat dhe mëditjet</b>	<b>37,492</b>	<b>37,608</b>



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)**  
**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

**10. Premite dhe shpërblimet**

Për vitin e përfunduar	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
<b>Premitë</b>		
Turneu "Ladies Open"	300	1,412
"Me te miret e vitit"	1,000	1,237
"Play & Stay Home"	-	-
Billie Jean King Cup	1,600	3,874
Davis Cup Ekipi	1,596	3,930
Turnete "Masters"	-	2,387
	<b>4,496</b>	<b>12,839</b>
<b>Shpërblimet</b>		
Turnetë "Adult"   Subvencionimi i shpërblimeve	40	6,195
Kampionati Ekipor	-	1,500
	<b>40</b>	<b>7,695</b>
<b>Gjithsej premitë dhe shpërblimet</b>	<b>4,536</b>	<b>20,535</b>

Të përfshira në premitë janë edhe kostot për kontribute pensionale dhe tatimet në të ardhura personale sipas ligjeve në fuqi.

**11. Anëtarësia vjetore**

Për vitin që përfundon	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
ITF	-	4,583
ETF	300	3,966
KOK	-	300
<b>Gjithsej anëtarësitë vjetore</b>	<b>300</b>	<b>8,848</b>

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)  
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022  
(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

**12. Shpenzimet sipas projekteve**

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021
<b>Perfaqesueset</b>		
Fed Cup / Billie Jean King CUP	11,635	15,372
Davis Cup	13,224	18,555
Te Kampionati per Junior - U14	4,747	-
Te Kampionati Zhvillimor - U12 & U14	-	7,424
Olimpiada Rinore / Lojerat Mesdhetare	1,927	-
ITF Kampionati Zhvillimor U18	197	-
<b>Gjithsej për perfaqesueset</b>	<b>31,730</b>	<b>41,351</b>
<b>Kampet</b>		
Per Teniste		
Tenisi Dimerore	9,147	6,840
Kampe ne Kosove	3,356	-
Kampe te tjera jashte Kosoves	3,758	-
National Teams	3,072	-
Programi intensiv i ushtrimeve U16	-	7,921
Kamp për grupmoshën U14	-	2,122
Kamp për grupmoshën U12	-	1,670
Festivali I tenisit	9,109	-
<b>Gjithsej per tenistë</b>	<b>28,442</b>	<b>18,552</b>
Per klube/trajnere	2,651	-
Ndihmat per pandemi	-	1,200
Certifikimi ITF (Nivelet I/II)	-	-
Certifikimi PTR dhe Kondicional	-	-
Seminare per trajneret	2,211	442
<b>Gjithsej per trajnere</b>	<b>4,862</b>	<b>1,642</b>
<i>Per refere dhe ndihmesa</i>		
Fed / Davis Cup, Ulqin	461	-
<b>Gjithsej per refere dhe ndihmesa</b>	<b>461</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>33,765</b>	<b>20,195</b>
<b>Te tjera</b>		
Perkrahja e pjesemarrjeve ne turne jashte vendit	5,584	16,655
Topa, kupa e rekuizita per turne dhe klube	2,536	21,168
Konferencat dhe kuvendet e ITF / ETF / FTK	6,529	5,482
Turnete: Masters   Peja Open U16   Mini - Tennis Championships	1,393	10,401
<b>Meditjet per mbikqyrje te turneve</b>	<b>2,833</b>	<b>5,643</b>
Ceremonia e shperblimeve "Laureatet e vitit"	2,280	1,431
Kampionati Ekipor (Shperblimet, ushqim e pije, panot)	250	2,811
Turenu "Ladies Open"	476	1,124
Teknologjia e Informacionit	916	2,633
Marketing	3,700	4,101
Infrastruktura Baloni	1,430	8,567
Turnete e klubeve në kuader të FTK-së	-	7,597
	<b>27,927</b>	<b>87,614</b>

**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)****SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022

(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

**11. Shpenzimet sipas projekteve (vazhdim)**

<b>Gjithsej shpenzimet sipas projekteve</b>	<b>93,422</b>	<b>149,160</b>
Pagat dhe shpenzimet e tjera administrative dhe te zyres	18,502	29,459
Takime/ Kryetari	4,905	
Anetaresite Vjetore	300	
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>117,129</b>	<b>178,619</b>

**12. Të hyrat e shtyera sipas donatorit dhe projektit**

Bilanci sipas donatorit dhe projekteve më 31 dhjetor 2022 është e dhënë në vijim:

	<b>Me 1 janar 2022</b>	<b>Shtuar gjate 2022</b>	<b>Gjithsej të disponueshme ne 2022</b>	<b>Shpenzimet gjate 2022</b>	<b>Me 31 dhjetor 2022</b>
<b>Financuar nga</b>					
MKRS 1	20,228	38,565	58,793	(72,302)	(13,509)
ITF AGM	14	473	487	(476)	11
ETF / PRESIDENT FUND	15	-	15	-	15
Komiteti Olimpik i Kosovës	700	1,400	2,100	(1,402)	698
BPB	539	-	539	-	539
ITF Grant per digjitaloizim	612	-	612	-	612
IFT Granti per Billie Jean King & Davis Cup Grant	2,120	38,469	40,588	(33,077)	7,511
ETF - National Program	-	2,500	2,500	(2,498)	2
ETF - Covid 19 emergency fund	0	-	0	-	0
ETF - Coaching workshop	61	500	561	(428)	133
ETF - Development Championship	2,210	2,397	4,607	(2,397)	2,210
Grant nga Development Workshop 2022	-	-	-	-	-
Komuna e Prishtines	-	3,240	3,240	(2,621)	619
<b>Të hyra e shtyra</b>	<b>26,498</b>	<b>87,545</b>	<b>114,042</b>	<b>(115,201)</b>	<b>(1,159)</b>

**Shfrytëzimi i të hyrave të shtyra**

	<b>euro</b>	
Për shpenzime - financuar nga grantet	-	115,201
<b>Gjithsej të hyrat e shfrytëzuara</b>	-	<b>115,201</b>



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS (FTK)  
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2022

(të gjitha vlerat e shprehura në Euro)

**12. Të hyrat e shtyera sipas donatorit dhe projektit (vazhdim)**

Bilanci sipas donatorit dhe projekteve më 31 dhjetor 2021 është e dhënë në vijim:

	Me 1 janar 2021	Shtuar gjate 2021	Gjithsej te disponueshm e ne 2021	Shpenzimet gjate 2021	Me 31 dhjetor 2021
<b>Financuar nga</b>					
MKRS	2,380	76,250	78,630	(78,402)	228
MKRS	-	20,000	20,000	-	20,000
ITF	2,286	2,937	5,223	(5,210)	14
ETF / PRESIDENT FUND	5,000	-	5,000	(4,985)	15
KOK	700	-	700	-	700
BPB	-	25,000	25,000	(24,461)	539
Eurokos JH	-	15,000	15,000	(15,001)	(1)
ITF Grant per digjitaloizim	3,245	-	3,245	(2,633)	612
IFT Granti per Billie Jean King & Davis Cup Grant	-	36,047	36,047	(33,927)	2,120
ETF - National Program	-	2,067	2,067	(2,067)	-
ETF - Covid 19 emergency fund	-	6,004	6,004	(6,003)	0.28
ETF - Coaching workshop	-	504	504	(442)	61
ETF - Development Championship	-	2,210	2,210	-	2,210
MKRS - Covid-19 ndihma për klube	1,200	-	1,200	(1,200)	-
<b>Te hyra te shtyera</b>	<b>14,811</b>	<b>186,018</b>	<b>200,829</b>	<b>(174,331)</b>	<b>26,498</b>
<b>Shfrytëzimi i të hyrave të shtyra</b>					<b>euro</b>
Per shpenzime - financuar nga grantet				-	174,331
<b>Gjithsej te hyrat e shfrytezuara</b>				-	<b>174,331</b>

**13. KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET**

**Çështjet ligjore**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, kompania nuk ka qenë e involvuar në ndonjë çështje ligjore, përveq atyre që ishin normale gjatë veprimtarisë së saj.

**14. Ngjarjet pasuese**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së autorizimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.